



R E P U B L I K A E S H Q I P È R I S Ë
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Tiranë, më 2 nëntor 2017

D E K L A R A T Ë

Asambleja e Akademisë së Shkencave e Shqipërisë më datë 31 tetor 2017, pasi diskutoi rreth mbarëvajtjes dhe të ardhmes së Akademisë së Shkencave në kuadër të reformës së kërkimit shkencor deklaron se:

- Mbështet plotësisht reformën e kërkimit shkencor dhe vazhdon të jetë e angazhuar në këtë proces, si dhe në reformimin e vet Akademisë së Shkencave, me synimin kryesor fuqizimin e saj.
- Në vijim të procesit të Berlinit për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, jemi të angazhuar për të marrë pjesë aktive në dialogun shkencë-politikë, por kërkojmë që dialogu të mbështetet në Kushtetutë, në parimin e shtetit të së drejtës, lirisë së kërkimit shkencor, në pavarësinë institucionale dhe në kodin e etikës. Asambleja e ASH, duke iu shmangur debatit emocional në komunikimin me epitete e metafora, njeh vetëm forcën e argumentit shkencor, logikës dhe fakteve.
- Akademia e Shkencave ka dhënë një kontribut të rëndësishëm me ndikim të konsiderueshëm, në kërkimin shkencor dhe zhvillimin e vendit. Megjithatë, Asambleja e ASH e sheh të nevojshme rritjen e kapaciteteve të saj, në drejtim të rolit që duhet të luajë Ajo në kërkimin shkencor dhe politikëbërjen për zhvillimin e shkencës, si dhe të politikave të zhvillimit të vendit mbështetur në arritjet bashkëkohore shkencore.
- Prandaj, Asambleja e ASH në kuadrin e procesit të reformimit do të miratojë më 16 nëntor projektpozimin e saj për reformën e ASH që do t'i dërgohet Këshillit të Ministrave dhe do të bëhet i njobur publikisht.

Ju faleminderit!

